

L I G J
Nr.7939, datë 25.5.1995

PËR MIGRACIONIN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Qëllimi
Neni 1

Ky ligj rregullon hyrjen e personave në Republikën e Shqipërisë dhe daljen e tyre prej saj. Krijon skemën për lehtësimin e emigrimit të rregullt për punësim jashtë të shtetasve shqiptarë. Rregullon nxjerrjen e vizave, lejet e qëndrimit e të punës, dhënien e strehimit, kushtet dhe procedurat për pranim dhe dëbim për imigrantët.

Subjektet
Neni 2

Subjekte të këtij ligji janë:

- a) Shtetasit shqiptarë të njohur si të tillë sipas legjislacionit shqiptar.
 - b) Personat që trajtohen në nenet e kreut të tretë të përcaktuar në këtë ligj si “të huaj”.
- Nuk janë subjekte të kreut të tretë të këtij ligji:

a) Personat që pretendojnë se janë shtetas të Republikës së Shqipërisë, nëse janë në gjendje të paraqesin një pasaportë shqiptare të vlefshme ose bindin autoritetet përkatëse shqiptare që janë shtetas shqiptarë.

b) Anëtarët e akredituar të misionëve diplomatike të huaj dhe pjesëtarët e përcaktuar të familjeve të tyre.

Respektimi i të drejtës ndërkombëtare
Neni 3

Ky ligj njeh dhe respekton parimet e përgjithshme të akteve ndërkombëtare.

Mosdiskriminimi
Neni 4

Nëpunësit e administratës shtetërore shqiptare, që angazhohen në zbatimin e këtij ligji ose të akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, zbatojnë detyrat e tyre në pajtim me parimet e përgjithshme të akteve ndërkombëtare dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë, pa marrë në konsideratë gjininë, kombësinë, racën, ngjyrën ose besimin e personave, të cilët kërkojnë të hyjnë, të dalin a të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë.

Përkufizime
Neni 5

Përcaktimet (përkufizimet) e mëposhtme kanë përdorim të veçantë në zbatimin e këtij ligji:

- a) “Migracion” nënkupton njëkohësisht dy terma: Emigracion dhe imigracion.
- b) “Emigracion” nënkupton daljen dhe hyrjen në Republikën e Shqipërisë të shtetasve shqiptarë.
- c) “Imigracion” nënkupton hyrjen dhe daljen në Republikën e Shqipërisë të shtetasve të huaj.
- ç) “I huaj” nënkupton çdo person, i cili nuk është shtetas shqiptar, sipas legjislacionit shqiptar për shtetësinë.
- d) “Vizë” nënkupton një autorizim zyrtar, lëshuar nga organet kompetente të qeverisë shqiptare, një të huaji, i cili është jashtë territorit të Shqipërisë dhe tregon se qeveria shqiptare nuk ka kundërshtim që i huaji të pranohet në territorin e saj.
- dh) “Kërkesë paraprake e detyrueshme për vizë” nënkupton që personat, të cilët janë subjekt i një kërkesë të tillë, duhet të marrin vizë para se të paraqiten në kufijtë e Shqipërisë.
- e) “Kërkesë ndihme nga fondet publike” nënkupton kërkesën për mbështetje nga fondet publike të Republikës së Shqipërisë, për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve vetjake për jetesë.
- ë) “Leje qendrimi” nënkupton një autorizim dhënë të huajit për të qendruar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Leja e qendrimit mund të jetë e kufizuar ose jo në kohëzgjatjen e saj dhe mund ta ndalojë të punojë të huajin gjatë kohës së qendrimit të tij në Shqipëri.
- f) “Pikë kufitare” nënkupton një vend në kufijtë tokësorë, detarë ose ajrorë të Republikës së Shqipërisë, që është caktuar si pikë zyrtare hyrjeje në Republikën e Shqipërisë.
- g) “Pasaportë” nënkupton një dokument të dhënë nga organet kompetente shtetasve, si vërtetim për identitetin e tyre dhe si provë e shtetësisë së tyre, për të lehtësuar udhëtimin jashtë vendit të shtetësisë.
- h) “Dokument udhëtimi” nënkupton një dokument që jepet nga organet kompetente, për të lehtësuar udhëtimin, por që nuk është domosdoshmërisht provë e identitetit a shtetësisë.
- i) “Bashkëshort-e” nënkupton partnerin në martesë, që njihet e vlefshme sipas parimeve të përgjithshme të ligjit privat ndërkombëtar. Çështjet e vlefshmërisë së martesës përcaktohen sipas ligjit të vendit të lidhjes së saj dhe çështjet e aftësisë së palëve për t’u martuar përcaktohen nga ligji i vendbanimit ose i shtetësisë së palëve.
- j) “Pasardhës” nënkupton fëmijë natyrorë a ligjorë, ose fëmijë ligjorë të brezave pasardhës.
- k) “Leje pune” është autorizimi për t’u punësuar në Republikën e Shqipërisë, dhënë nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë të huajve, të cilët përndryshe nuk kanë të drejtë të punojnë. Lejet e punës mund të jenë të kufizuara ose jo në kohë dhe mund të autorizojnë çdo lloj punësimi, ose mund ta kufizojnë mbajtësin e tyre në një punësim të specifikuar.
- l) “Leje vetëpunësimi” nënkupton një autorizim dhënë nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë të huajve për t’u vetëpunësuar. Lejet e vetëpunësimit mund të jenë të kufizuara ose jo në kohë dhe mund të autorizojnë ushtrimin e çdo veprimtarie vetëpunësimi a mund ta kufizojnë mbajtësin në një veprimtari të specifikuar.
- m) “Kërkesë për strehim” nënkupton një kërkesë për t’u njohur si mbajtës i statusit të refugjatit, sipas kushteve të Konventës së Gjenevës të vitit 1951, lidhur me statusin e refugjatëve.

KREU II EMIGRIMI

E drejta për t’u larguar nga Republika e Shqipërisë Neni 6

- a) Çdo person ka të drejtë të largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë.
- b) E drejta për t’u larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë nuk kufizohet. Bëjnë përjashtim rastet për të mbrojtur sigurimin kombëtar, rendin publik, shëndetin publik, moralin, të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Këto raste janë të parashikuara në ligj dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të akteve ndërkombëtare e detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.
- c) E drejta për t’u larguar kufizohet me vendim gjyqate, të bazuar në gjykimin e çdo rasti me konstatimin edhe të njëjës nga rrethanat e mëposhtme:
 - i) Parandalimin e largimit ilegal të fëmijëve të mitur.
 - ii) Ndalimin e largimit të një personi, i cili është subjekt për ndjekje penale, ose vuan dënimin.

- iii) Ruajtjen e shëndetit publik dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve serioze.
 - iv) Refuzimin e kërkesës për t'u pajisur me pasaportë një personi, i cili është riatdhesuar me shpenzime publike dhe nuk ka ripaguar shpenzimet e riatdhesimit.
 - v) Refuzimin e kërkesës për t'u pajisur me pasaportë një personi, aftësitë mendore të të cilit janë vlerësuar nga gjykata të dëmtuara, aq sa largimi i tij do të sillte një rrezik serioz për vetveten ose për të tjerët.
- Çdo shtetas shqiptar, i cili largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë, ka të drejtë të rikthehet. Në pajtim me këtë qëllim, mundësia e pajisjes me leje kalimi i jepet çdo shtetasi shqiptar, që është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga përfaqësitë diplomatike.
- Përcaktimet e paragrafeve ci - c. të nenit 6 nuk zbatohen për shtetasit shqiptarë që janë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Skema për emigrim dhe punësim

Neni 7

1. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë harton aktet për të ngritur një skemë, që më poshtë do të quhet "Skema", për të nxitur e lehtësuar emigrimin e rregullt dhe kthimin e shtetasve shqiptarë, të cilët dëshirojnë të ushtrojnë veprimtari ekonomike jashtë Republikës së Shqipërisë.

2. Personat që nuk përfshihen në skemë, nuk kufizohen nga e drejta për t'u larguar nga Republika e Shqipërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

3. Personat që marrin pjesë në skemë:

a) ruajnë të drejtën e votës në zgjedhjet kombëtare e lokale pavarësisht nga mungesa e tyre në Republikën e Shqipërisë;

b) ruajnë të drejtën e pensionit, sigurimit shëndetësor, arsimor, social dhe të përfitimeve të tjera shoqërore për vete e për pjesëtarët e përcaktuar të familjeve të tyre, duke u përfshirë në skemën e sigurimeve shoqërore, pavarësisht nga fakti nëse banojnë ose jo në Republikën e Shqipërisë;

c) përjashtohen nga taksat për shumat e parave të dërguara në Shqipëri nga jashtë, sa kohë që ata banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ose pas kthimit të tyre në Shqipëri;

ç) kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë nga fondet e përcaktuara publike pas kthimit të tyre në Republikën e Shqipërisë.

Personat që largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë për të ushtruar veprimtari ekonomike, pa marrë pjesë në skemë, nuk kanë automatikisht të drejtën për çdo përfitim, që mund të krijohet sipas nënparagrafeve (a)-(ç) të këtij neni. Kjo e drejtë mund t'u kalohet këtyre personave me akte të veçanta.

Detyrat e ministrisë së punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe ish të përndjekurve politikë

Neni 8

Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë:

a) përcakton punëdhënësit të përshtatshëm në vendet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët dëshirojnë t'i ofrojnë punësim shtetasve shqiptarë;

b) bindet se këto oferta punësimi bëhen në pajtim me ligjet lokale në vendin e punësimit dhe në veçanti se do të zbatohen si duhet të gjitha kërkesat lidhur me lejet e banimit, lejet e punës, ligjet e punës, si dhe të gjitha aktet e tjera për punësimin dhe ruajtjen e shëndetit e të sigurimit;

c) sigurohet që mundësia për të marrë pjesë në skemë është e hapur për të gjithë shtetasit shqiptarë pa dallim race, gjinie, kombësie, ngjyre ose besimi dhe e bën publike nëpërmjet zyrave lokale të punës.

KREU III HYRJA DHE BANIMI

Vizat

Neni 9

Personave që nuk kanë vizë dhe që janë subjekti i një kërkesë paraprake të detyrueshme për vizë sipas akteve të nxjerra në zbatim të këtij ligji, mund t'u refuzohet hyrja në Republikën e Shqipërisë vetëm për këtë arsye. Të pasurit e një vize nuk i jep të drejtë mbajtësit të saj të hyjë në Republikën e Shqipërisë, nëse ministri përgjegjës bindet se viza është marrë me mashtrim a gënjeshtër, por i jep të drejtë mbajtësit të vizës që para heqjes së kësaj të drejte të ankohet në gjykatë.

Neni 10

a) Personave që kërkojnë leje për të hyrë a qendruar në Republikën e Shqipërisë dhe që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, mund t'u refuzohet kjo leje, nëse ministri i Brendshëm personalisht vendos që përjashtimi i tyre është i domosdoshëm, në interes të politikës publike, sigurimit publik ose sigurimit shëndetësor.

b) Masat e marra për arsye të politikës publike ose sigurimit publik bazohen krejtësisht në sjelljen vetjake të individit të interesuar. Sëmundjet dhe pamundësitë që përlligjin refuzimin e lejes së hyrjes, janë ato të përfshira në listat e akteve të nxjerra në zbatim të këtij ligji. Personat e dëbuar për këto arsye kanë të drejtën e ankimit në gjykatë.

Neni 11

Nëse kërkesa paraprake e detyrueshme për vizë është e domosdoshme sipas akteve të nxjerra në zbatim të këtij ligji, viza u jepet personave kur:

a) paraqesin një pasaportë të vlefshme, një dokument udhëtimi ose një dokument tjetër, të përcaktuar si të pranueshëm nga autoritetet shqiptare, sipas akteve të nxjerra në zbatim të këtij ligji;

b) paraqesin prova se ata kanë mjete për t'u mbajtur ose mbahen nga të tjerët, pa punuar dhe pa iu drejtuar fondeve publike për periudhën, gjatë së cilës mendojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë;

c) paguajnë kuotat e përcaktuara sipas akteve të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Neni 12

Personat e mëposhtëm, të cilët kërkojnë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të pranohen për një periudhë që nuk i kalon tre muajt:

a) kur janë subjekt i një kërkesë paraprake për vizë;

b) në të gjitha rastet kur:

- paraqesin pasaportë të vlefshme, dokument udhëtimi ose dokument tjetër, të përcaktuara

si të pranueshme nga autoritetet shqiptare kur subjekti është regjistruar në organet kompetente të vendqendrimit të deklaruar;

- në paraqitjen e provave që kanë mjete për të mbajtur veten ose të mbahen nga të tjerët pa punuar dhe pa iu drejtuar fondeve publike. Personat të cilët nuk i plotësojnë kushtet e mësipërme u refuzohet hyrja në Republikën e Shqipërisë.

Lejet e qëndrimit

Neni 13

Personat që janë pranuar në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë jo më të gjatë se tre muaj, sipas nenit 12 të këtij ligji, kanë të drejtë që gjatë kësaj periudhe t'i bëjnë kërkesë Ministrisë së Brendshme për zgjatjen e saj ose për ndryshimin e vendbanimit të tyre në Republikën e Shqipërisë.

Personat, kërkesat e të cilëve për zgjatjen e kohës së qëndrimit ose për ndryshimin e vendbanimit janë në shqyrtim nga Ministria e Brendshme, konsiderohen banues të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, deri atëherë kur ata urdhërohen të largohen nga vendi, sipas neneve 34 e 35

të këtij ligji.

Neni 14

Zgjatja e qëndrimit të përkohshëm mund t'u jepet, pas kërkesës, për një periudhë tjetër gjer në tre muaj, personave që vazhdojnë të përmbushin kushtet për të qëndruar në Republikën e Shqipërisë, të cilat parashtrihen në pikat a dhe b të nenit 12 të këtij ligji.

Neni 15

Kanë të drejtë të marrin leje qëndrimi të vlefshme deri në një vit dhe mund ta ripërtërijnë atë pas kësaj periudhe këta persona:

a) bashkëshortët e shtetasve shqiptarë, pasardhësit e tyre që janë nën 18 vjeç ose që janë në ngarkim të tyre;

b) të afërmit në ngarkim në shtetasve shqiptarë e bashkëshortëve të tyre të çfarëdo kombësie (nëna, babai);

c) pjesëtarët e familjes që nuk përfshihen në pikat a dhe b të këtij neni, por që janë në kujdestari të shtetasve shqiptarë ose bashkëshortëve të tyre, banues në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këta persona të bindin ministrin e Brendshëm se kanë mjete për të mbajtur veten ose për t'u mbajtur, pa iu drejtuar fondeve publike.

Pjesëtarët e familjes, të cilët marrin lejen e qëndrimit në pajtim me këtë nen, kanë të drejtë të punësohen a vetëpunësohen, ose të angazhohen në çfarëdo veprimtari tregtare si shtetasit shqiptarë, pa pasur nevojë të marrin leje pune nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë.

Neni 16

Studentët e pranuar për një kurs studimesh në një institucion arsimor shqiptar, publik ose privat të përcaktuar, pajisen me leje qëndrimi të vlefshme deri në një vit, që mund të përsëritet, nëse provojnë se kanë mjete për të mbajtur veten dhe çdo njeri tjetër në ngarkim, të pranuar ose që kërkon pranim, pa punuar dhe pa iu drejtuar fondeve publike. Sipas akteve të hartuara në zbatim të këtij ligji, studentëve mund t'u jepet leje për t'u punësuar nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë.

Neni 17

Leje qëndrimi, të vlefshme deri në një vit dhe të përsëritshme pas kësaj, u jepen personave që investojnë një shumë parash në një sipërmarrje tregtare në Republikën e Shqipërisë, duke krijuar kështu punësim për shtetasit shqiptarë dhe për ata në ngarkim të tyre. Përmasa e investimit dhe numri i vendeve të punës përcaktohen në aktet e hartuara në zbatim të këtij ligji.

Neni 18

1. Lejet e qëndrimit deri në një vit dhe të përsëritshme pas kësaj u jepen personave, subjekteve të neneve të kreut të tretë të këtij ligji, që kanë marrë leje pune nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë. Këto leje jepen nëse kjo ministri vendos se punësimi i tyre është në interes të vendit.

2. Personat dhe pjesëtarët e familjeve të tyre që nuk janë shtetas shqiptarë, për shkak se nuk janë në gjendje të kthehen në vendin nga kanë ardhur, sipas neneve 24 deri 28 të këtij ligji, nuk punësohen në Republikën e Shqipërisë, në qoftë se nuk marrin leje pune nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë.

Neni 19

Leje qëndrimi deri në një vit dhe të përsëritshme pas kësaj u jepet personave, subjekte të

neneve të kreut të tretë të këtij ligji, të cilët dëshirojnë të vetëpunësohen në Republikën e Shqipërisë, nëse këtyre personave u është dhënë leje vetëpunësimi nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë, duke u bazuar në atë që vetëpunësimi i tyre të jetë në interes të vendit.

Neni 20

Lejet e qëndrimit, të vlefshme deri në një vit dhe të përsëritshme pas kësaj, u jepen personave, subjekte të neneve të kreut të tretë të këtij ligji, të cilët janë punësuar ose përfaqësojnë kompani e organizata të huaja, që do të ndërmarrin projekte në Republikën e Shqipërisë sipas ligjeve në fuqi.

Neni 21

Bashkëshortja dhe pasardhësit nën 18 vjeç, ose edhe mbi 18 vjeç dhe që janë në ngarkim të personave të pranuar sipas neneve 16-20 të këtij ligji, do të pajisen me leje qëndrimi, të vlefshme sa kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejes së qëndrimit të mbajtësit kryesor duke paraqitur prova se ata mund të mbahen pa iu drejtuar fondeve publike.

Neni 22

Leje qëndrimi, të vlefshme deri në një vit dhe të përsëritshme pas kësaj, u jepen personave që njihen si refugjatë, sipas përcaktimeve të nenit 24, ose që njihen si persona të cilët nuk mund të dëbohen nga Shqipëria për arsyet e parashikuara në nenet 26-27 të këtij ligji.

Leje punësimi u jepet këtyre personave në bazë të kërkesës, duke u njohur të drejta të njëjta me personat që janë shtetas shqiptarë.

Bashkëshortja dhe pasardhësit nën 18 vjeç ose edhe mbi 18 vjeç dhe që janë në ngarkim të personave që kanë marrë leje qëndrim sipas këtij neni, do të pajisen me leje qëndrimi, të vlefshme sa kohëzgjatja e vlefshmërisë së qëndrimit të mbajtësit kryesor.

Neni 23

Vizat dhe lejet e qëndrimit gjithashtu mund t'u jepen personave të cilët nuk plotësojnë kërkesat e neneve 15-22 të këtij ligji. Ministri i Brendshëm vendos personalisht që pranimi i këtyre personave është në interes të Republikës së Shqipërisë.

Azili dhe kategoritë e lidhura me të

Neni 24

Personat, që për shkak të persekutimit për arsye race, feje, kombësie, pjesëmarrje në një grup shoqëror a politik, janë jashtë vendit të kombësisë së tyre dhe nuk kanë mundësi të mbrohen në këtë vend, ose ata që nuk kanë kombësi janë jashtë vendit të banimit të tyre formal të zakonshëm dhe nuk kanë mundësi të kthehen në të, njihen si refugjatë në bazë të procedurave të caktuara në aktet e nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Neni 25

Personi pushon së qeni refugjat në kuptim të këtij ligji, në qoftë se:

a) ka kryer një krim kundër paqes, një krim lufte ose një krim kundër njerëzimit, sipas përcaktimeve të akteve ndërkombëtare;

b) ka kryer një krim të rëndë jopolitik jashtë Shqipërisë, para se ai të pranohet në Shqipëri si refugjat;

c) merr shtetësinë shqiptare ose shtetësinë e ndonjë vendi tjetër dhe gëzon mbrojtjen e atij shteti, shtetësinë e të cilit ka marrë;

ç) rivendoset vullnetarisht në vendin nga i cili ishte larguar, ose jashtë të cilit ai kishte mbetur si rezultat i frikës së persekutimit;

d) nuk mund të vazhdojë të refuzojë mbrojtjen e vendit të shtetësisë së tij, pasi rrethanat në të cilat ai është njohur si refugjat kanë pushuar si të tilla, ose në rast se ka humbur shtetësinë e tij, ai vazhdon të refuzojë të kthehet në vendin e mëparshëm të banimit të tij.

Neni 26

Nuk dëbohen, kthehen ose dërgohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ata persona që kanë frikë të mirëbazuar se jeta ose liria e tyre kërcënohen për shkak të racës, gjinisë, besimit, kombësisë, përkatësisë në një grup shoqëror të veçantë apo opinione politike të tyre, në kufijtë e territoreve ku i kërcënon ky rrezik.

Neni 27

Nuk dëbohen, kthehen ose dërgohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë personat që kanë një frikë të mirëbazuar se do t'i nënshtrohen torturave a trajtimit çnjerëzor ose poshtërues për çdo arsye tjetër, në kufijtë e territoreve ku i kërcënon ky rrezik.

Nuk dëbohen, kthehen ose dërgohen në një shtet tjetër gjithashtu ata persona, për të cilët ka arsye të forta për të menduar se atje rrezikohen të dënohen me vdekje.

Neni 28

Çdo person që ndodhet në kufirin e Republikës së Shqipërisë ose brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse ka hyrë në Shqipëri në mënyrë të ligjshme ose jo, dhe që dëshiron të qëndrojë në Shqipëri si refugjat sipas dispozitave të këtij ligji, duhet t'i drejtohet organit përkatës të përcaktuar në aktet e nxjerra në zbatim të këtij ligji. Asnjë kërkues azili nuk dërgohet në një vend tjetër për t'iu shqyrtuar kërkesa, derisa t'i jetë dhënë mundësia për të paraqitur arsyet se përse kjo kërkesë duhet të shqyrtohet në Republikën e Shqipërisë e jo në një vend tjetër dhe pasi këto arsye të jenë shqyrtuar tërësisht.

Askush që ka paraqitur një kërkesë për azil, e cila është refuzuar, nuk dëbohet nga Shqipëria pa iu dhënë mundësia e rishqyrtimit sipas procedurave përkatëse.

Shkeljet

Neni 29

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative:

1. Hyrja me vetëdije në territorin e Shqipërisë, pa u paraqitur për inspektim te nëpunësi që përcaktohet në aktet e nxjerra në bazë të nenit 4 të këtij ligji.

2. Qëndrimi në territorin e Shqipërisë për më shumë se tre muaj, pa autorizimin e përcaktuar në nenet 13-23 të këtij ligji.

3. Paraqitja me vetëdije e materialeve të rreme te nëpunësi i ngarkuar me zbatimin e këtij ligji dhe të akteve të nxjerra në bazë të tij, për të marrë vizë paraprake, vizë hyrjeje ose leje qëndrimi sipas neneve 11-23 të këtij ligji.

4. Punësimi ose vetëpunësimi i shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë, veç atyre pjesëtarë të familjes të përcaktuar në nenin 15 të këtij ligji, pa marrë paraprakisht leje punësimi nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë, si përcaktohet në nenet 16-19 të këtij ligji.

5. Të gjitha veprimet e tjera të subjekteve të këtij ligji, që nuk përputhen me dispozitat e këtij ligji dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij.

Shkeljet e parashikuara në pikat e mësipërme të këtij neni dënohen me gjobë nga 1000 deri në 100 000 lekë.

Neni 30

Për kundërvajtjet administrative të parashikuara sipas nenit 29 të këtij ligji dënimet me gjobë jepen nga nëpunësit e përcaktuar në aktet e nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Neni 31

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi kundër vendimeve të dënimit dhe ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 32

Shkeljet e përcaktuara në nenin 29 nuk përbëjnë kundërvajtje administrative për personat e përcaktuar në nenet 24, 26, 27 dhe 28 të këtij ligji.

Dëbimi

Neni 33

Personat, subjekte të neneve të këtij ligji, që banojnë ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk dëbohen prej këtej, përveç zbatimit të një vendimi të marrë në pajtim me ligjin.

Ata kanë të drejtë:

- a) të paraqesin arsyet kundër dëbimit të tyre;
- b) të kërkojnë rishikimin e rasteve të tyre;
- c) të përfaqësohen për këto qëllime pranë një autoriteti kompetent të përcaktuar në aktet e nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Këta persona mund të dëbohen para ushtrimit të të drejtave të tyre sipas pikave a, b, dhe c të këtij neni, vetëm kur ky dëbim është i domosdoshëm në interes të rendit publik ose bazohet në arsyet e sigurimit kombëtar.

Neni 34

Personat, subjekte të neneve të këtij ligji që banojnë jo ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, dëbohen sipas procedurave të përcaktuara në aktet e nxjerra në zbatim të këtij ligji, të cilat publikohen.

Neni 35

Në të gjithë rastet, kur është marrë vendim për të dëbuar një person nga Republika e Shqipërisë, pikat e mëposhtme zbatohen, pavarësisht nëse personi është ligjërisht apo jo i pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë:

1. Personat, të cilët kanë një kërkesë të argumentuar se dëbimi i tyre nga Republika e Shqipërisë përbën një ndërhyrje në të drejtën e tyre për të respektuar jetën private a familjare, siç garantohet nga parimet e përgjithshme të akteve ndërkombëtare të pranuara nga Shqipëria. Ata kanë të drejtë në të gjitha rastet që për vendimin e dëbimit t’i drejtohen gjykatës, duke iu dhënë e drejta për një përfaqësim ligjor.

2. Personat, të cilët kanë një arsye të argumentuar se dëbimi i tyre nga Republika e Shqipërisë i ekspozon ndaj rrezikut të dënimit me vdekje, torturues ose trajtimi çnjerëzor e poshtërues, në të gjithë rastet kanë të drejtë që kundër vendimit të dëbimit t’i drejtohen gjykatës duke iu njohur e drejta për një përfaqësim ligjor në këto procedura gjyqësore.

Ndalimi dhe arrestimi

Neni 36

Kur ka të dhëna se me veprimet e personave që bëjnë përpjekje për të hyrë në mënyrë të paaautorizuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, ekzistojnë elemente të ndonjë vepre penale, duhet të kërkohet procedimi penal i tyre si dhe marrja e masave të ndalimit dhe arrestimit në përputhje me legjislacionin penal shqiptar.

KREU IV
AKTET NË ZBATIM TË KËTIJ LIGJI

Neni 37

Këshilli i Ministrave nxjerr akte nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me dispozitat kryesore kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Këto akte duhet të parashikojnë:

a) detyrimin për një kërkesë paraprake, të detyrueshme për vizë për shtetasit e atyre vendeve, të cilët i përcakton Ministria e Punëve të Jashtme;

b) detyrimin për një kërkesë paraprake, të detyrueshme për vizë, për ato kategori personash, të cilat i përcakton ministri i Brendshëm ose ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë, pagimin e çdo kuote a takse, lidhur me procedurat për administrimin e këtij ligji.

c) përcaktimin e procedurave për marrjen dhe shqyrtimin e të gjitha vendimeve sipas këtij ligji;

ç) mbajtjen e regjistrave nga hotelet dhe banesa të tjera, ku parashikohet strehimi e fjetja me pagesë për personat që qëndrojnë në këto banesa, për t'u dhënë autoriteteve publike informacionin e duhur nga këto regjistra;

d) ngritjen e skemave për të lehtësuar emigrimin e rregullt dhe kthimin e shtetasve shqiptarë, të cilët dëshirojnë të ushtrojnë veprimtari ekonomike jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 38

Ligji nr.7517, datë 8.10.1991 “Për punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe çdo dispozite tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 39

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1120, datë 7.6.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha